



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0815
Data e Vendimit: 10.09.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “EKO” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 647-25-5386-2-2-1, iniciuar nga “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, në cilësinë e autoritetit kontraktues, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 10 .09.2025, mori këtë:

Vendim

I.Hedhet si e palejuar(parakohshme) ankesa e “EKO” me nr. të protokollit 2025/0815 e datës 26.08.2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 647-25-5386-2-2-1, iniciuar nga “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS” nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” numër të prokurimit 647-25-5386-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 26.08.2025 ka pranuar ankesën me nr.0815/2025 nga OE “EKO” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 647-25-5386-2-2-1,

inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 647-25-5386-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, me datë 03.04.2025 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë të AK afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data 26.08.2025. Ndërsa OE ankues “EKO” me datën 26.08.2025 në ora 12:08 ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, dhe ende pa u marrë vendimi ndaj kërkesës për Rishqyrtim OE ankues “EKO” ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 26.08.2025 në ora 12:27.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrorë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund të drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: *“Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliken me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.”* Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: *“Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenin 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.*

AK “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 647-25-5386-2-2-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK, duhet të veprojë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit të, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - EKO**
- Arkivës së OSHP-së: